



REPUBLIKA E SHQIPËRIE  
BASHKIA FIER

Nr. 7169 Prot

Fier, më 03/07/2024

### SHPALLJE

Në bazë të Ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”. Vendim Nr.1096, datë 28.12.2015 “Për miratimin e rregullave, kushteve e procedurave për përdorimin dhe menaxhimin e hapësirës publike”, si dhe Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.106, datë 30.11.2022 “Mbi strukturën dhe nivelin e taksave të vitit 2023”, në bazë të sezonit të verës, shtimit të numrit të vizitorëve dhe turistëve të huaj, gjithashtu dhe festave të fundvitit, është e nevojshme të ketë aktivitetet dhe t’ju vijë në ndihmë të rinjëve dhe fëmijëve të qyteti, me një shtim të numrit të lojrave për fëmijë dhe të rinjë në ambientet publike të bashkisë Fier të bëhet shpallje publike, për të gjithë subjektet, të cilët janë të interesuar për të vendosur lojra në ambientet publike të bashkisë Fier, si ***në parkun qendror të qytetit dhe në sheshin qendror***, për:

- ***Periudha kohore 2 vite***

#### Dokumentacioni që duhet të dorëzojnë subjektet duhet të jetë si më poshtë vijon:

1. Kërkesën nga subjekti ku të shprehin interesin për vendosjen e lojrave për fëmijë dhe të rinj drejtuar bashkisë Fier
2. Periudhën kohore të cilën do shfrytëzojnë hapësirën publike
3. Përcaktimin e zones, për të cilën kërkohet të shfrytëzimi
4. Ofertën për subjekt të periudhës kohore
5. QKB-në e subjektit, ku të jetë përcaktuar lloji i këtij aktiviteti
6. Foto të lojrave që posedojnë
7. Vërtetim të gjëndjes teknike të lojrave dhe paisjeve, të certifikuara nga subjekt i licensuar ose specialist përkatës të fushës, duke specifikuar sigurinë dhe garancinë e veprimtarisë së subjektit aplikues
8. Deklaratë nga subjekti e kthimit të gjëndjes së mëparshme të hapësirës publike, pas përfundimit të aktivitetit

*Informojmë gjithashtu se përzgjedhja e subjektit do të vlerësohet në bazë të ofertës më të mirë.*

**Afati i dorëzimit të kërkesave për shfaqje interesi nga subjektet është deri në datën 20/07/2024.**

*Publikimi do të bëhet me shpallje dhe në një prej gazetave.*

KRYETAR

Armando SUBASHI

